



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A.
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

**Drejtuar: Operatorit Ekonomik “ MARKETING & DISTRIBUTION ” SH.P.K, me NIPT
J72124001N**

Me adresë: Tiranë, Kashar Kashar, Autostrada Tiranë - Durrës, Km 10,

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: Mall;

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”;

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-88026-05-29-
2026;

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti i II-të: Blerje Letër A4 “Traktor”, me fond limit me
vlerë 9,600,000 (nëntë milion e gjashtëqind mijë) lekë, pa T.V.SH.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 29.05.2026;

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini, nr. 37,
08.06.2026;

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐ X

Me anë të kësaj, ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k, me NIPT J62426002Q dhe me vlerë të ofertës ekonomike 9,560,000 (nëntë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa T.V.S.H.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori Ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k., me NIPT J72124001N dhe me vlerë të ofertës ekonomike 7,400,000 (shtatë milion e katërqind mijë) lekë, pa T.V.SH.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Operatori Ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k., me NIPT L91418502J nuk ka paraqitur vlerë të ofertës ekonomike.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Operatori Ekonomik “ Adel CO ” sh.p.k., me NIPT L22117021M dhe me vlerë të ofertës ekonomike 8,960,000 (tetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, pa T.V.SH.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. Operatori Ekonomik “Inpress” sh.p.k., me NIPT L52122014L dhe me vlerë të ofertës ekonomike 7,200,000 (shtatë milion e dyqind mijë) lekë, pa T.V.SH.
- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrja janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k., me NIPT L91418502J nuk ka paraqitur vlerë të ofertës ekonomike dhe nuk ka ngarkuar asnjë dokument në sistemin elektronik të APP-së, në lidhje me procedurën me objekt: “Blerje Letër fotokopje A4, Letër AK “Traktor”, Loti i II-të: “Blerje Letër A4 “Traktor”, dokumente të kërkuara sipas kriterëve të Dokumentave Standarte të Tenderit. Operatori Ekonomik ka ngarkuar në sistemin e APP Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”, si dhe “Formularin e Sigurimit të Ofertës”, për procedurën me objekt: “Blerje Letër fotokopje A4, Letër AK “Traktor”, Loti i I-rë: “Blerje Letër fotokopje A4”. Gjithashtu nuk ka paraqitur fizikisht në datë 13.07.2026 ora 10:00 dorëzimin e mostrave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor sipas orarit të njoftimit të kontratës.

Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u konstatua se Operatori Ekonomik:

Nuk i plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim.

Nuk i plotëson kriteret për kapacitetin ekonomik dhe financiar për kualifikim.

Nuk i plotëson kriteret për kapacitetin teknik për kualifikim.

Nuk i përmbush specifikimet teknike të paraqitura në DST.

Për rrjedhojë në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që oferta e mësipërme nuk kualifikohet.

2. Operatori Ekonomik “Inpress” sh.p.k., me NIPT L52122014L dhe me vlerë të ofertës ekonomike 7,200,000 (shtatë milion e dyqind mijë) lekë, pa T.V.SH., i cili nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush kriteret teknike, pasi:

Në Shtojcën 6, Formulari i Specifikimeve Teknike, për Lotin e II-të: “Blerje Letër A4 “Traktor”, për faqen e parë – kopje prapa – CB – Coated Back, ka dhe këto dy specifikime teknike:

Ashpërsia në përkulje:

MD > 11 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 3 mN

Për faqen e dytë – kopje para dhe prapa – CFB coated front and back, ka edhe këto dy specifikime teknike:

Ashpërsia në përkulje: MD > 11 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 3 mN

Dhe për faqen e tretë – kopja para CF coated front, ka edhe këto dy specifikime teknike:

Ashpërsia në përkulje: MD > 12 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 4 mN

Në dokumentat e paraqitura nga Operatori Ekonomik “INPRESS” sh.p.k., në Skedën Teknike të përkthyer në gjuhën shqipe të dorëzuar, këto specifikime teknike janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, por në Skedën Teknike origjinale të prodhuesit, këto specifikime teknike janë përkatësisht:

Për faqen e parë – kopje prapa – CB – Coated Back, ka dhe këto dy specifikime teknike:

Ashpërsia në përkulje: MD > 11 nN

Ashpërsia në përkulje: CD > 3 nN

Për faqen e dytë – kopje para dhe prapa – CFB coated front and back, ka edhe këto dy specifikime teknike:

Ashpërsia në përkulje: MD > 11 nN

Ashpërsia në përkulje: CD > 3 nN

Dhe për faqen e tretë – kopja para CF coated front, ka edhe këto dy specifikime teknike:

Ashpërsia në përkulje: MD > 12 nN

Ashpërsia në përkulje: CD > 4 nN

Për më tepër, në pikën 2.3.5 të DST, shprehet qartë se “Operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë **Letër A4“Traktor” (3kopje)** si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik, në lidhje me specifikimin teknik për parametrin “Ashpërsia në përkulje”, rezulton një mospërputhje ndërmjet kërkesave të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe dokumentacionit teknik të prodhuesit. Në përkthimin e noterizuar të skedës teknike, njësia e matjes është paraqitur si mN, duke mos qenë në përputhje me dokumentin origjinal të prodhuesit.

Duke qenë se nN dhe mN janë njësi matëse të ndryshme dhe se Dokumentet e Tenderit kërkojnë përmbushjen e specifikut në mN, dokumenti origjinal i prodhuesit nuk provon përmbushjen e kërkesës teknike të përcaktuar në DST.

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nuk provon përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara në Dokumentet e Tenderit, konkretisht për parametrat e “Ashpërsisë në përkulje” MD dhe CD.

Për këtë arsye, oferta vlerësohet si e papërputhshme me kërkesat teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe operatori ekonomik nuk kualifikohet.

Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u konstatua se Operatori Ekonomik: Nuk i përmbush specifikimet teknike të paraqitura në DST.

Për rrjedhojë në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që oferta e mësipërme nuk kualifikohet.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatori ekonomik “**MARKETING & DISTRIBUTION ” SH.P.K, me NIPT J72124001N**, me adresë: Tiranë, Kashar Kashar, Autostrada Tiranë - Durrës, Km 10, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **7,400,000 (shtatë milion e katërqind mijë) lekë, pa T.V.SH.**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Etjen Xhafaj

ME AUTORIZIM
DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË
ADMINISTRIMIT
Elion Semanaj